



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:073988

Datë: 10.07.2023

Numri i dokumentit: 04539581

P. nr. 98/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve E. D. dhe M. E., të akuzuar për bashkëkryerje të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.128-9/19 e datës 24.01.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik me datë 04.07.2023, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Nuredini dhe të pandehurve dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 10.07.2023, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

I pandehuri E. D., nga i ati N., e ëma I., e gjinisë I., i lindur me dt..... në Sh.... ku edhe tani jeton rr. “.....”/....., me numër personal të lejes së njoftimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka të kryer fakultetin e biokimisë, punëtor, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

I pandehuri M. E., nga i ati S., e ëma N., e gjinisë J., i lindur me dt....., në Sh..... ku dhe tani jeton, rr. “.....”/....., me numër personal të lejes së njoftimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i dy fëmijëve, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i dënuar më parë për vepër të njëjtë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

JANË FAJTOR

Me datë 25.11.2018, rreth orës 17:30, në rrugën “...” në Ferizaj, njësitit i Stacionit Policor në Ferizaj, gjatë kontrollit rutinor kanë ndaluar veturën e tipit ” BMW”, ngjyrë e zezë, me targa të regj., të cilën e drejtonte i pandehuri E. D., e në të cilën veturë ka qenë edhe i pandehuri M. E..... dhe gjatë kontrollit të veturës janë gjetur dy qese me substancë narkotike të llojit kokainë me peshë prej 0.87 gr. dhe dy tableta Ekstazi, të cilat substanca narkotike me kontribut të përbashkët i kanë blerë dhe i kanë poseduar pa autorizim, me ç ,rast dhe iu janë konfiskuar përkohësisht nga policia.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 41, 42, 43, 46, 49, 51, 52, 73, 74 dhe 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),si dhe neni 364, 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

GJYKON

Të pandehurin e parë

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti dhe me dënim në të holla në shumë prej 300 € /treqind euro/.

Të pandehurin e dytë

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti dhe me dënim në të holla në shumë prej 300 € /treqind euro/.

Dënimet e shqiptuara me burg nuk do të ekzekutohen me kusht që të pandehurit brenda afatit prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryejnë veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimet e tillë do të revokohen, ndërsa dënimet e shqiptuara me gjobë janë të obliguar ti paguajnë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se të pandehurit nuk i paguajnë dënimet me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, të njëjtat dënime do t’u shndërrohen në dënime me burgë ashtu që për çdo 20 Euro, do t’u llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 € /njëzetë euro/, ndërsa në emër kompensimin të Viktimave të Krimit shumën prej nga 20 € (njëzetë euro), në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109, të Ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit, brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në bazë të nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-së, i konfiskohen në mënyrë të përhershme substancat narkotike llojit kokainë me peshë prej 0.87 gram dhe dy tableta Ekstrazi, të cilat i janë gjetur të pandehurve gjatë kontrolleve nga policia.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën e saj PP.II.nr.128-9/2019 e datës 24.01.2019, ka ngarkuar të pandehurit për bashkëkryerje të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitura për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj Gjykate, pasi veprat penale për të cilën janë proceduar për të pandehurit gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datën 04.07. 2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe të pandehurit.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre në kuptim të nenin 241 par.1 të KPRK-së, dhe pasi që i pandehurit kanë deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

I pandehuri parë në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se, e pranoj fajësinë për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e bëj në mënyrë vullnetare, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

I pandehuri i dytë në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se, e pranoj fajësinë për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e bëj në mënyrë vullnetare, premtoj që në të ardhmen më nuk do të përsërisë këso vepra penale apo të ngjashme pasi që tani veq e kam kuptuar se përdorimi i narkotikëve është i dëmshëm pasi që edhe më parë unë një kohë të gjatë kam qenë përdorues i narkotikëve dhe një herë kam qenë i dënuar me një aktgjykim të formës së prerë në gjykatë të Prishtinës me dënim me të holla, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve deklaron se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që një pranimin i tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe korrekte duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ku një pranimin i tillë është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe tu shqiptoj një sanksion penale sipas ligjit, përkitazi për caktimin dhe llojin e lidhur me lartësinë e dënimit i propozoj gjykatës që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe si rrethanë rënduese kihet parasysh pasi që të dy deklaruan se edhe më parë për një kohë të gjatë kanë qenë përdorues të narkotikëve. Në bazë të nenit 275 par.3 të KPRK-së propozoj gjykatës që substanca narkotike e llojit kokainë me peshë prej 0.87 gram dhe dy tableta ekstazi të konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova

materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti i oficerit i dt.25.11.2018, Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve i dt. 25.11.2018, Raporti i testit fushor i dt. 05.12.2018 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të bashkëkryerjes së veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose anologe nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të pandehurit e kanë bërë pranimin e fajësisë, janë penduar për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti se sipas deklarimeve të tyre janë përdorues të narkotikëve për një kohë dhe i pandehuri i dytë edhe me parë ka qenë dy herë i dënuar me aktgjykime të plotfuqishme për vepër të njëjtë penale nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe përveç rrethanave të sipërpërmendura gjykata vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tilla, duke marrë parasysh edhe faktin se të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimet e shqiptuara janë plotësisht të justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorëve të saj, që do të shërbej në

parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskimin në mënyrë të përhershme të substancave narkotike, është marr konform nenit 275 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.1 lidhur me nenin 449 par.2 nen par.2.6 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
P.nr. 98/19, datës 10.07.2023**

Zyrtare ligjore

Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.